



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 07.03.2018,
e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Nol Nushi (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Drilon Pireva (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Egzon Azemi (LVV), Yll Rugova (LVV), Genc Sherifi (LVV), Adrian Berisha (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Visare Gashi (LVV), Valbona Petrovci (LVV), Vala Peshku (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Milot Podvorica (LVV), Mimoza Sylejmani (LVV), Qëndrim Sahiti (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Sami Salihu (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Sokol Havolli (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Milazim Vitija (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Naime Osmani (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Migjen Shala (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Yll Bogaj (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sokol Berisha (AAK), Suzan Kika (AAK), Vesel Makolli shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci, (AKR-AA), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA), Rifat Deri (AKR-AA) dhe Bukurie Canolli (LB).

Munguan: Vlora Dumoshi (LDK), Uran Ismaili (PDK) dhe Baton Dushi (Nisma).

Të pranishëm ishin edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe të KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues i Kuvendit. Kryesuesi ftoi z. Bashkim Beha që ta bëjë betimin para Kuvendit.

Bashkim Beha bëri betimin para anëtarëve të Kuvendit.

Para se të miratohej rendi i ditës, **kryesuesi** hapi diskutimin rreth rendit të ditës.

Kryesuesi propozoi që në rend dite të futet për diskutim edhe pika "Formimi i grupit punues për plotësim-ndryshimin e Rregullores së Kuvendit dhe komiteteve.

Halim Halimi propozoi që të jetë i njëjti grup punuese edhe për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2018 dhe Rregullores për punën e Kuvendit dhe të komiteteve.

Agim Gashi propozoi që pika e dytë e rendit të ditës, "Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit zhvillimor komunal "Prishtina 2018-2026"", të harmonizohet me dokumentet paraprake dhe të formulohet kështu: "Propozimvendimi për propozim ndryshimin dhe plotësimin e Planit zhvillimor komunal 2018-2026", sepse nuk ka askund në botë që mund të jenë në fuqi dy dokumente paralele, andaj në bazë ligjore do të ishte shumë e drejtë që kjo pikë e rendit të ditës të harmonizohet me dokumentet paraprake.

Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, tha se këtë çështje e kemi diskutuar e dhe në KPF, kjo është e rregulluar me Ligjin e planifikimit, andaj nuk guxojmë me e quajtur dokumentin Plotësim-ndryshim, por Plan zhvillimor komunal.

Eman Rrahmani propozoi që pika numër 6, "Propozimi për formimin e Komitetit për komunitete", të largohet nga rendi i ditës, për shkak të shkeljes së Rregullores për procedurën e themelimit, sepse është shkelur rregullorja pasi që nuk është konsultuar askush me shefin e GP të LVV-së.

Kryesuesi tha se anëtarët e komunitetit shumicë do të propozohen sot në mbledhje.

Sami Boroci theksoi se në KPF është diskutuar që një anëtar do të jetë nga koalicioni i LVV-së, AKR-së, Alternativës dhe AAK-së, pra para seancës të propozohet një anëtar nga koalicioni, sepse kam menduar që shefat e GP-ve duhet të vendosin për këtë pikë, për atë nuk është propozuar anëtari prej koalicionit të lartpërmendur.

Shefqet Osmani propozoi që pika e nëntë "Pyetje dhe përgjigje", të jetë si pikë e parë e rendit të ditës, pasi që diku rreth 80% e ekzekutivit është këtu në sallë dhe do të kemi mundësi të marrim përgjigje nga shumica e drejtorëve.

Nol Nushi shprehu mendimin se do të ishte mirë që pyetjet për problemet konkrete të dorëzohen pak më herët te kryesuesi, ku pastaj kryesuesi ua drejton drejtorëve ato pyetje ose ato probleme, në mënyrë që përgjigjet me qenë shumë më të sakta. Pra pyetjet të dorëzohen me shkrim dhe përgjigjet të merren në seancën e radhës.

Leutrim Retkoceri kërkoi nga drejtorët e drejtorive që të jenë të pranishëm në sallë, po ashtu edhe kryetari, sepse shumë pika me rëndësi janë duke u injoruar nga kryetari i Komunës me mospraninë e tij këtu, gjë që po tregon edhe mosinteresimin e tij për punët që janë me rëndësi për kryeqytetin.

Ardian Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, tha se kur i patëm sjellë ndryshimet dhe plotësimet e planeve rregulluese ekzistuese, Ministria na pati thënë se dokumentet ekzistuese nuk mund t'i ndryshoni, për shkak se neni 26 i Ligjit të planifikimit, i ka lënë në fuqi derisa të nxirren dokumentet e reja të planifikimit në harmoni me Ligjin e ri të planifikimit.

Halim Halimi tha se kjo që po insistohet për miratimin e kësaj pike, është në kundërshtim me ligjin, andaj e përkrah edhe z. Agim që kjo që kjo pikë e rendit të ditës të harmonizohet me dokumentet paraprahe.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin ashtu si ishte në rendin e ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, 13 kundër, 5 abstenime, u miratua formulimi i pikës së dytë të rendit të ditës ashtu si është propozuar nga drejtorja përkatëse: "Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit zhvillimor komunal "Prishtina 2018-2026".

Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës, bashkë me propozimin e z. Halimi, që të jetë i njëjti grup punuese për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2018 dhe të Rregullores për punën e Kuvendit dhe të komiteteve.

Sipas propozimit të z. Halimi, kryesuesi konstatoi se më 43 vota për, 3 kundër dhe 1 abstenim, u miratua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit zhvillimor komunal "Prishtina 2018-2026";
3. Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Hartës zonale të komunës së Prishtinës 2018-2026";
4. Raporti financiar buxhetor (TM 4) janar - dhjetor 2017;
5. Propozimvendimi për miratimin paraparak të dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS);
6. Propozimvendimi për formimin e Komitetit për komunitete;
7. Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2018 dhe të Rregullores për punën e Kuvendit dhe të komiteteve;
8. Propozimplani i veprimit për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës 2018-2020;
9. Pyetje dhe përgjigje;
10. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se më 42 vota për dhe 1 kundër, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e dytë

Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit zhvillimor komunal "Prishtina 2018-2026".

Kryesuesi hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Leonora Shabani-Bajraktari, në emër të GP të LVV-së, bëri të ditur se e votojnë dhe e përkrahin për miratim hartimin e Planit zhvillimor komunal për vitin 2018-2026.

Halim Halimi në emër të GP të LDK-së, tha se e kemi analizuar këtë propozimvendim dhe mendojmë që ky propozimvendim duhet të quhet "Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit zhvillimor të Komunës së Prishtinës 2018-2026". Ne kërkojmë që të ndryshohet dhe plotësohet ky propozimvendim.

Leutrim Retkoceri, në emër të GP të PDK-së, bëri të ditur se grupi i PDK-së e ka analizuar këtë propozimvendim, por i ka analizuar edhe kërkesat dhe shqetësimet e qytetarëve që kanë të bëjnë me këtë plan zhvillimor. Ai shprehu mendimin se këtu është duke munguar transparenca dhe diskutimi me qytetarë për fillimin e këtij plani. Ne nuk mund të ecim përpara duke i nënvlerësuar planet e kaluara dhe duke kërkuar plane të tjera, pa i përfillur dhe pa i dëgjuar qytetarët fillimisht. Ky është vlerësimi dhe qëndrimi ynë. Përderisa është kjo qasje, ne nuk do ta votojmë një fillim të hartimit të këtij plani me këto mangësi.

Lidhur me vërejtje dhe sugjerimet e z. Retkoceri, **Genc Bashota**, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, **Ardian Olluri**, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, **Arben Vitia**, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe **Jonuz Salihaj**, drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhanë sqarime të nevojshme.

Fadil Gashi, në emër të GP të AAK-së, shprehu përkrahje për miratimin e këtij propozimvendim.

Vesel Makolli, në emër të GP të AKR - AA, e përkrahu miratimin e këtij propozimvendimi.

Nol Nushi tha se sigurisht që qytetarët e Prishtinës kanë shqetësime të ndryshme dhe nuk mundet asnjë plan me qenë perfekt për secilin qytetar, sepse ai pastaj nuk do të

ishite plan, por ai do të ishte plotësim dëshirash, e Komuna është këtu për të bërë plane afatgjata e jo plotësim dëshirash.

Eman Rrahmani u shpreh se ne të gjithë e dimë si është gjendja në ato lagje që u diskutua nga parafolësit, ku në veçanti u diskutuan edhe nga drejtorët e drejtorive përkatëse. Nuk është mirë që të akuzohen drejtorët pse nuk kanë shkuar në vizitë në atë lagje dhe mendoj se është jo e shëndetshme me folur në këtë mënyrë këtu para qytetarit.

Rifat Deri tha se në lagjen “Veterniku” i kemi mbajtur disa takime, ku ka pasur banorë edhe të asaj lagje që kanë marrë pjesë në ato takime dhe kemi shprehur shqetësimet tona në lidhje me atë se pse ajo lagje nuk ka QMF, pse nuk ka shkollë, pse nuk e ka edhe një paralele të parashkollorëve. Me fillimin e hartimit të Planit të ri zhvillimor të komunës së Prishtinës, po besoj se në këtë plan do të inkorporohen të gjitha kërkesat e banorëve të asaj pjese të Prishtinës.

Sami Boroci u shpreh në përkrahje të drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë, i cili ka bërë një punë shumë të madhe në përzgjedhjen e lokacionit për ndërtimin e QMF-së, si një lokacion më i miri, më ideal për atë pjesë të asaj lagjeje.

Ai po ashtu i shtroi pyetje drejtorit Genc Bashota, duke e pyetur se sa mund të jetë kostoja komplet për hartimin e këtij plani.

Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, tha se për Planin zhvillimor komunal i kemi të buxhetuara 75 mijë euro, ndërsa për Hartën zonale 100 mijë euro.

Burbuqe Hydaverdi, përfaqësuese e Drejtorisë së Ekonomisë dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, në pika të shkurtra i njoftoi të pranishmit rreth hartimit të Planit zhvillimor komunal dhe Hartës zonale të komunës.

Egzon Azemi u shpreh i pajtimit me diskutimin e disa anëtarëve, duke thënë se ne këtu jemi duke diskutuar për Planin zhvillimor, por nuk është në rregull kështu, në emër të një kërkesë të qytetarëve me u përpjekur për të përfituar kaq ulët politikisht, sepse vetëm sa po e zhvlerëson atë kërkesë të qytetarëve.

Shefki Gashi, sa u përket bashkësive lokale, ai tha se bashkësitë lokale nuk pranohen si institucione lokale që janë të parapara me Rregullore dhe Statutin e Komunës. Atje në terren punohet me komisarë politikë të VV-së, dhe bashkësitë lokale nuk janë kurrkund të konsultuara, absolut. Para tri viteve, komisioni për zgjedhjen e kryetarëve për bashkësi lokale, ka zgjedhur vetëm një kryetar dhe më nuk ka vazhduar puna e zgjedhjes së kryetarëve të bashkësive lokale, që do të thotë se atje është një papërgjegjësi totale. Sot po flasim për tri dokumente që janë shumë me rëndësi, si Plani zhvillimor komunal, Harta zonale dhe raporti financiar buxhetor,

andaj kërkoi nga kryesuesi që të jemi më serioz, që të sillen vendime serioze në Kuvendi, e mos të veprohet si në mandatin e kaluar.

Adrian Berisha shprehu mospajtimin e tij me qëndrimet e parafolësve, në veçanti me diskutimin e znj. Kumrije Shabani dhe z. Shefki Gashi.

Ai sugjeroi që disa nga anëtarët e Kuvendit të mos jenë paragjykses sa i përket moshës, gjinisë, racës, sepse është shumë keq të ndodh kjo në vitin 2018.

Pas diskutimeve të shumta, **kryesuesi** e hodhi në votim propozimvendimin.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, 18 kundër, u miratua Vendimi për fillimin e hartimit të Planit zhvillimor komunal "Prishtina 2018-2026".

Pika e tretë

Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Hartës zonale të komunës së Prishtinës 2018-2026.

Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, i njoftoi të pranishmit rreth fillimit të hartimit të Hartës zonale të komunës së Prishtinës 2018-2026.

Leonora Shabani- Bajraktari, në emër të GP të LVV-së, e përkrahu fillimin e hartimit të Hartës zonale të komunës së Prishtinës.

Halim Halimi, në emër të GP të LDK-së, e përkrahu fillimin e hartimit të Hartës zonale, por me dilema, sepse, siç u shpreh ai, na është thënë se Harta zonale veç ka përfunduar. Meqë nuk kemi pasur Hartë zonale asnjëherë, se Ligji për planifikim hapësinor e parasheh, për këtë ne e përkrahim hartimin e Hartës zonale për komunën e Prishtinës.

Blerand Stavileci, në emër të GP të PDK-së, theksoi se meqë edhe kjo pikë hyn pothuajse në të njëjtën natyrë të punëve të cilat do të bëhen në të ardhmen, ne do të donim që sikurse edhe për pikën paraprake, edhe për këtë t'i përmbahemi në radhë të parë afateve kohore në bazë të ligjit, por edhe që të ketë një transparencë në raport me ne dhe me qytetarët.

Fadil Gashi, në emër të GP të AAK-së, e përkrahu fillimin e hartimit e Hartës zonale.

Vesel Makolli, në emër të GP të AKR-AA- së, u shpreh në përkrahje të fillimit të hartimit të Hartës zonale.

Eman Rrahmani lidhur me Hartën zonale, kërkoi nga drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të dijë se pse gjatë vitit të kaluar janë paraparë 250 mijë euro, kurse gjatë këtij viti 100 mijë euro, dhe a parashihet se do të mund të ketë

probleme për shkak të zhvillimit të debateve me qytetarë lidhur me Planin zhvillimor komunal dhe Hartën zonale.

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga z. Rrahmani, **Genc Bashota** dha sqarime të nevojshme.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimvendimin.

Kryesuesi konstatoi se më 45 vota për, asnjë kundër, u miratua Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Hartës zonale të komunës së Prishtinës.

Pika e katërt

Raporti financiar buxhetor (TM 4), janar-dhjetor 2017.

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me këtë pikë.

Ismail Kokaj, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, tha se meqë kam qenë pjesë e këtij raporti, shfrytëzoj rastin ta vazhdoj leximin e tij. Buxheti i planifikuar për vitin 2017 ka qenë 62 milionë €, kurse bartje kanë qenë 8 milionë e 700 mijë € dhe gjithsej buxheti ka qenë 70 milionë €. Shpenzimet e këtij buxheti për vitin 2017 kanë qenë 56 milionë e 684 mijë €. Viti 2017 ka qenë si viti i të hyrave, ku nga planifikimi i paraparë për 24 milionë e 607 mijë €, janë realizuar mjetet prej 24 milionë e 533 mijë €.

Eman Rrahmani, në emër të GP të LVV- së, tha se në këtë raport shihet qartë se në shumë sektorë nuk janë shpenzuar mjetet të cilat janë parashikuar, dhe këtu nuk kemi asnjë shpjegim pse nuk janë realizuar, ose edhe kur janë tejkaluar të hyrat të cilat janë në buxhet. Ai kërkoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës, në mënyrë që të mund të ofrohet një raport më i qartë i të gjithave shpenzimeve.

Sokol Havolli vlerësoi se ky raport nuk ka të bëjë fare me raport financiar, kur dihet se ligji i parasheh edhe kriteret se çka duhet të përmbajë një raport tremujor financiar. Ne e kuptojmë çka është buxheti dhe çka është pasqyra financiare, edhe raporti natyrisht se duhet me i përmbajtur ato tabelat kryesore, e që duhet ta kenë një analizë, një komentim të atyre numrave. Pra, ky raport ka të meta në secilën kategori. Raporti është i përgatitur jashtëzakonisht dobët, pa kurrfarë shpjegimi, pa kurrfarë informate, andaj GP i LDK-së do të jetë kundër këtij raporti, sepse është raport ofendues për ne dhe publikun. Këtu ka edhe një lloj lajthitje brenda këtij teksti, diku thuhet tremujori, e në kllapa vihet, 1 janar-31 dhjetor, pra është raport tremujor apo është raport vjetor!

Blerand Stavileci u shpreh se ky është një raport i papranueshëm, me shumë gabime, qofshin materiale, teknike, profesionale dhe gjuhësore. Thuhet është raport i përgatitur nga kryetari i Komunës, kryetari nuk vjen, është punë e tij, por këtë duhet ta shohim përtej dallimeve politike dhe partiake. Krahasuar me vitin e kaluar, janë anashkaluar në tërësi ose pjesërisht disa shpenzime faktike në lidhje me secilën

kategori të shpenzimit. Këto gabime, defekte, mangësi reflektohen pikërisht te njëri nga elementet, kategoritë esenciale të buxhetit, që janë investimet kapitale. Duke marrë për bazë të gjitha këto, votimi i këtij raporti duhet të shtyhet.

Fadil Gashi, në emër të GP të AAK-së, tha se ky raport duhet të shtyhet, pasi që nuk kemi shumë të dhëna për të.

Sami Boroci, në emër të GP të AKR-AA-së, tha se këtë raport e kemi analizuar me kujdes, andaj dhe kemi konstatuar se votimi i këtij raporti duhet të shtyhet, në mënyrë që të plotësohet më shumë në çështjet që u ceken edhe nga parafolësit.

Fiknete Bejta tha se duke u bazuar në një analizë të këtij raporti, konstatoj se ky raport financiar është një material i dobët, i cili nuk bazohet në Ligjin për financat publike dhe përgjegjësitë, është pa përmbajtje, me probleme numerike dhe me elemente kundërshtuese në mes të pozicioneve financiare. Këtij raporti i mungon krahasimi, analiza e kontekstit dhe sqarimi i numrave në kuptimin e realizimit të kontratave dhe projekteve etj.

Egzon Azemi u shpreh se unë do të votoj kundër këtij raporti, sepse një raport i tillë financiar më shumë i ngjan një organizate joqeveritare, sesa një organi apo një institucioni siç është Komuna e Prishtinës.

Agim Gashi theksoi se ky raport nuk ka bazë ligjore, sepse nuk i ka plotësuar as kriteret elementare që i përcakton Ligji për menaxhimin e financave publike, por ajo që bie në sy janë gabimet elementare, apo lëshimet elementare, të cilat nuk e di pse i kanë futur ashtu. P.sh. në raport asnjë fjalë nuk thuhet për ndërmarrjet komunale, që janë pronë e Komunës së Prishtinës, për të cilat përgjegjës është kryetari i Komunës së Prishtinës. Shihet se në disa kode buxhetor janë paraqitur shpenzime për disa projekte dhe nuk dihen se kur janë ndërtuar ato objekte. Duke marrë për bazë këto lëshime elementare, konsideroj se ky raport nuk duhet të votohet.

Naime Osmani u shpreh se ky raport kur të na sillet me ndryshimet dhe plotësimet, kërkoj që t'i specifikojnë të gjitha projektet të cilat janë kryer, pasi që këtu përfshihen dhe janë cekur shumat të cilat janë harxhuar. Projekti për ndërtimin e kanalizimit në fshatin Besi ka dëmtuar rrugën dhe kemi kërkuar që ajo të sanohet. Po ashtu kemi kërkuar rrethimin e varrezave në fshatin Tenezhdoll dhe në Vranidoll, si dhe rregullimin e disa rrugicave, kanalizimin dhe ujësjellësin për fshatin Rimanishtë etj.

Adrian Berisha tha se do të ishte mirë që diskutimet të përqendrohen kryesisht rreth çështjes së financave. Konstatuam se raporti është skandaloz, votohet apo nuk votohet, të shkojmë para.

Leutrim Retkoceri theksoi se raporti financiar buxhetor është duke u diskutuar në mënyrë konstruktive edhe nga koalicioni qeverisës, andaj besoj që pas kthimit dhe

përmirësimet të këtij raporti, në seancat e ardhshme do të diskutojmë konkretisht për të hyrat vetanake dhe për defektet tjera.

Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, dha sqarime të nevojshme lidhur me shqetësimet e ngritura nga znj. Osmani.

Kryesuesi e hodhi në votim raportin.

Kryesuesi konstatoi se më 9 vota për, 33 kundër dhe 3 abstenime, nuk u miratua raporti financiar buxhetor (TM4), janar-dhjetor 2017.

Pika e pestë

Propozimvendimi për miratimin paraprak të dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuum dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS).

Kryesuesi hapi diskutimin

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin paraprak të dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuum dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), në pika të shkurta të pranishmit i informoi Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës.

Leonora Shabani-Bajraktari në emër të GP të LVV-së, tha se në parim e mbështesim kërkesën nga KEDS-i, kështu që vetëm në qoftë se ka ndonjë rregullore që e rregullon shfrytëzimin e pronës së Komunës për rrjetin e energjisë elektrike, pra nëse mund të faturohet shfrytëzimi i pronës së Komunës që e ka KEDS-i, për shkak se KEDS është një kompani private, komerciale, ku pastaj këto të hyra kishin formuar një fond, dhe mendimi im është që ai fond të dedikohet për arsim, konkretisht për punësimin e mësimdhënësve mbështetës të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Faleminderit!

Shefki Gashi, në emër të GP të LDK-së, tha se edhe ne e miratojmë ndarjen e pozicionit për KEDS-in, por të mos anashkalohen edhe disa zona rurale, siç janë fshatrat Llukar, Makoc, Mramur, Busi e Slivovë, të pajisen me trafo, pasi që rrejtja është i vjetruar dhe bëhet humbje e dyfishtë e energjisë elektrike. Do të ishte mirë që Komuna ta udhëheqë atë proces, pra në një formë me e kushtëzuar edhe atë kompaninë private me ndarjen e parcelave aty ku ka nevojë për vendosjen e trafove.

Blerand Stavileci, në emër të GP të PDK-së, tha se këtë ndarje të lokacionit që ne do ta votojmë sot, është e qëlluar dhe në dobi të qytetarëve.

Fadil Gashi, në emër të GP të AAK-së, tha se edhe ne e përkrahim për miratim këtë propozimvendim.

Sami Boroci, në emër të GP të AKR- AA, e përkrahu votimin e kësaj pike.

Eman Rrahmani propozoi që kjo pikë të shtyhet, me arsyetimin se KEDS-i është duke i diskriminuar shumicën e lagjeve të Prishtinës. Unë kisha kërkuar që njëherë të zgjidhen këto probleme, pastaj të vendoset për dhënien e pronave, të kësaj prone dhe secilës pronë që i nevojitet, në mënyrë që të krijojë një përmirësim të gjendjes së energjisë.

Adrian Berisha sugjeroi që të gjithë anëtarët e Kuvendit t'i marrin ankesat nga qytetarët dhe të formohet një listë me kërkesat e qytetarëve, pastaj t'i drejtohem KEDS-it për të shikuar mundësinë e zgjidhjes së problemeve në disa vendbanime të komunës.

Lidhur me çështjet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit, **Dren Kukaj**, drejtor i Drejtorisë së Pronës, dha sqarime të nevojshme.

Pas diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votim propozimvendimin.

Kryesuesi konstatoi se më 44 vota për, 1 kundër, u miratua Vendimi për miratimin paraprak të dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS).

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për formimin e Komitetit për komunitete.

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit, duke cekur se për anëtarë të Komitetit për Komunitete është bërë propozimi nga ana e shumicës, mirëpo nuk është bërë nga ana e LVV-së.

Leonora Shabani-Bajraktari, për anëtare të komitetit propozoi znj. Valbona Petrovci

Kryesuesi e hodhi në votim propozimvendimin për këtë përbërje të Komitetit:

1. Valbona Petrovci, përfaqësuese e shumicës;
2. Elmire Nikçi-Rexha, përfaqësuese e shumicës;
3. Hetem Kupina, përfaqësues i shumicës;
4. Nenad Miladinoviç, përfaqësues i komunitetit serb;
5. Oktaj Kurteshi, përfaqësues i komunitetit turk;
6. Mirsada Behluli, përfaqësuese e komunitetit boshnjak;
7. Idriz Berisha, përfaqësues i komunitetit ashkali;
8. Adnan Ajeti, përfaqësues i komunitetit rom dhe
9. Kimete Shok, përfaqësuese e komunitetit goran.

Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për, 6 kundër dhe 3 abstenime, u miratua Vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2018 dhe të Rregullores së punës së Kuvendit dhe komiteteve.

Kryesuesi tha se në këtë grup punues të gjitha subjektet politike përfaqësohen me nga një anëtar, një nga Zyra ligjore, një nga Zyra e sekretarisë së Kuvendit dhe një përfaqësues nga ekzekutivi.

Kryesuesi konstatoi se grupi punues ka këtë përbërje:

1. Agim Kuleta, LB, kryesues;
2. Egzon Azemi, LVV, anëtar;
3. Agim Gashi, LDK, anëtar;
3. Leutrim Retkoceri, PDK, anëtar,
4. Valbona Ajeti, AAK, anëtare;
5. Arbenita Murseli, AKR-AA, anëtare;
6. Bukuriye Canolli, LB, anëtare;
7. Baton Dushi, Nisma, anëtar dhe
8. Nol Nushi, Grupi i pavaruar, anëtar.

Kryesuesi konstatoi se më 42 vota për, 2 kundër, u miratua Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2018 dhe Rregulloren e punës së Kuvendit dhe komiteteve.

Pika e tetë

Propozimplani i veprimit për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës 2018-2020.

Leonora Shabani-Bajraktari, në emër të GP të LVV-së, tha se e përkrahim Planin e veprimit për persona me aftësi të kufizuara, por që të krijohet edhe një komision për ecurinë e këtij plani, për shkak se personat me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës, jo vetëm në komunën e Prishtinës, janë komuniteti më i marginalizuar sa i përket qasjes së ofrimit të shërbimeve të tyre.

Halim Halimi, në emër të GP të LDK-së, tha se edhe ne e përkrahim këtë plan të veprimit. Duke i marrë parasysh persona me aftësi të kufizuara, është shumë me rëndësi të zbatohet ky plan.

Leutrim Retkoceri, në emër të GP të PDK-së, tha se e përkrahim Planin e veprimit për persona me aftësi të kufizuara, veçse ne kishim kërkuar që në të ardhmen të formohet një komision mbikëqyrës për zbatimin e këtij plani.

Valbona Ajeti, në emër të GP të AAK-së, tha se edhe ne e përkrahim Planin e veprimit për personat me aftësi të kufizuara.

Vesel Makolli në emër të GP të AKR-AA, e përkrahu miratimin e këtij plani dhe zbatimin e tij në praktikë.

Adrian Berisha u shpreh se sa i përket këtij plani, do të ishte mirë të dihet se kush janë personat përgjegjës për zbatimin e tij, a kanë me qenë grupet punuese të përbashkëta, së bashku me asamblistë apo vetëm drejtoritë, sepse në grupin tonë parlamentar ka asamblistë që me vetëdëshirë dhe me vullnet do të ishte pjesë e atij grupi punues.

Naime Osmani e përkrahu miratimin e këtij plani dhe sugjeroi që në rastet e konkurseve për pranim të punëtorëve, të punësohet ndonjë familjar i personave me aftësi të kufizuara, në rastet kur janë në kushte të barabarta me kandidatët e tjerë.

Arbenita Murseli, tha se personat me aftësi të kufizuara e presin ndihmën dhe mbështetjen tonë, andaj duhet t'u lehtësohet një qasje e veçantë në arsim e gjetiu, pra të jenë të integruar njësojë si të gjithë të tjerët. Me theks të veçantë, sugjeroi që organizatat joqeveritare që ofrojnë shërbime sociale për persona me aftësi të kufizuara, të financohen nga Komuna e Prishtinës, sidomos "Hendikos". Duhet të rregullohet qasja në objekte dhe në rrugë dhe të merret parasysh punësimi i personave me aftësi të kufizuara, në çdo pesëdhjetë të punësuar të jetë një person i tillë.

Rifat Deri pyeti se në këtë plan a përfshihen edhe personat e verbër dhe a hyn në grupin e personave me aftësi të kufizuara alfabeti "Brajd".

Lidhur me shqetësimet e ngritura nga parafolësit, **Muhedin Nushi**, drejtor i drejtorisë së Administratës dha sqarime të nevojshme.

Sokol Havolli theksoi se është shumë e rëndësishme që personat me aftësi të kufizuara të jenë njësojë të integruar edhe në çdo sferë të jetës, shoqërisë, shkollës e kështu me radhë.

Mimoza Sylejmani tha se Komuna e Prishtinës edhe vitin e kaluar është marrë edhe me shoqatën "Hendikos" dhe unë vullnetarisht kam qenë e kyçur në këtë proces, ku kemi pasur takime me drejtorin Muhedin Nushi, drejtorin Arben Vitia dhe ish - drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, ku kemi punuar së bashku, që personat me aftësi të kufizuara në këto shërbime të kenë një qasje më të lehtë.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimplanin.

Kryesuesi konstatoi se më 44 vota për, u miratua Plani i veprimit për persona me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës 2018-2020.

Pika e nëntë Pyetje dhe përgjigje

Kumrije Shabani – Ramadani, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë.

Vizitat mjekësore me termin e kanë komplikuar shumë situatën, kështu që është ngarkuar shumë Qendra Klinike Universitare e Kosovës. Në këtë rast epidemie të gripit, në vend që t'iu dalim në ndihmë qytetarëve 24 orë, është bërë me termin, kështu që më së keqi kanë pësuar gratë shtatzëna, pleqtë dhe fëmijët.

Pse gratë shtatzëna nuk marrin trajtim mjekësor në QMF, si p.sh. kur ka qenë gripi sezonal, por ato drejtohen te gjinekologu? A është kjo ikja nga përgjegjësia e mjekëve, apo është ndonjë leverdi e lidhur me ordinancat private?

Pse inspektorët nuk dalin në terren për t'i inspektojnë mjekët të cilët janë të lidhur me kompanitë farmaceutike, kështu që pacienti nuk e merr barin e kërkuar, mirëpo merr çka i ofron kompania?

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga znj. Shabani, **Arben Vitia**, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, dha sqarime të nevojshme.

Shefqet Osmani, pyetje për drejtorinë e Shërbimeve Publike.

Tash e një vit në Zonën industriale Prishtinë – Fushë-Kosovë, është një rrjedhë e ujit enorme, ku derdhen me mijëra e mijëra kub ujë të cilat dalin në sipërfaqe ose në rrugën. Kërkoj sanimin e kësaj gjendje.

Një objekt i cili gjendet pranë shkollës “Asim Vokshi”, i cili është në gjendje të mjerueshme tash e 20 vjet, e që nuk i dihet titullari, është privatizuar dy-tri herë dhe tash ka mbetur në mëshirë të kohës. Ky objekt për fat të keq përdoret prej narkomanëve, prej përdorueseve të drogave dhe për qëllime kriminale të njerëzve të cilët kanë interes. Çka do të bëhet me atë objekt?

Adrian Berisha, pyetje për Drejtorinë e Inspektionit.

Banorët e Banesave të solidaritetit para 4 muajve kanë bërë një petition lidhur me tunelin në Kurriz, në lagjen “Dardania”. Tuneli është në gjendje jashtëzakonisht të keqe, me fekale, eshtra të shpërndarë nga mishtoret, tymi i byrektores “Bosna”, tri dukuri d.m.th. të cilat janë shumë të këqija për shëndetin. Kërkoj që të merren masa në parandalimin e tyre.

Naime Osmani, pyetje për drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave.

Kërkoj nga drejtorët, apo edhe nga personat përgjegjës të drejtorive përkatëse, sidomos te infrastruktura, mundësisht të më njoftojnë me projektet të cilat janë në plan të realizohen gjatë këtij viti, në mënyrë që mos t'i përsëris unë kërkesat e njëjta herë pas here.

Po ashtu, kërkoj që të zbatohet një vendimi që është marrë në Kuvend, që asamblistët të lirohemi nga pagesa për ofrimi të shërbimeve mjekësore brenda QMF-ve.

Për pyetjet e parashtruar nga znj. Osmani, **Arben Vitia** drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe **Gëzim Mehmeti**, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, dhanë sqarime të nevojshme.

Eman Rrahmani propozoi që në mbledhjen e radhës të Komitetit për Politikë dhe Financa, pika “Të ndryshme” të jetë pikë e parë e rendit të ditës.

Kryesuesi tha se kjo çështje do të rregullohet me një rregullore të re.

Sami Boroci, pyetje për Kryetarin e Komunës.

Kam kërkuar që Drejtoria e Parqeve të ridizajnohet dhe të quhet Drejtoria e Ambientit dhe e Parqeve. Kërkoj të dijë se deri ku ka arritur ky proces dhe kur planifikohet të realizohet.

Jeta Rafuna-Hasani, pyetje për Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Menaxhimit të Kontratave.

Në rrugën “Bajram Bahtiri” është bërë një gropë shumë e madhe, e cila paraqet rrezik për këmbësorë, sidomos për fëmijët që shkojnë në shkollë.

Për pyetjen e parashtruar nga znj. Rafuna, **Gëzim Mehmeti**, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, dha sqarime të nevojshme.

Arbenita Murseli, pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

Çështja e mungesës së ndriçimit në lagjen “Mati 1”, përkatësisht në rrugën “Tasim Elezi”, ku nga orët e para të mbrëmjes deri në orët e para të mëngjesit është errësirë absolute. Kërkesat e qytetarëve të kësaj lagjeje janë që sa më shpejt të intervenohet në këtë pjesë.

Në lagjen “Sofalia”, përkatësisht rruga “Sabit Mushica”, ka qenë e degraduar dhe vazhdon të jetë në atë mënyrë. Ngjashëm janë edhe gropat e hapura në rrugën “Muarrem Fejza” tek rrethi i rrugës “B”, përkatësisht para barnatoreve, ku gropat janë thuajse krejtësisht të hapura dhe po paraqesin rrezik. Kërkoj që të bëhet sa më shpejtë sanimi i tyre.

Për pyetjet e parashtruara nga znj. Murseli, **Gëzim Mehmeti**, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, dha sqarime të nevojshme.

Rifat Deri, kërkesë për Drejtorinë e Administratës, Drejtorinë e Arsimit, Drejtorinë e Pronës dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

Shoqata e të Verbërve kërkon që të pajiset me një printer të alfabetit të Brajdit, pasi që roli i këtij printeri ka të bëjë me përgatitjen e të gjithë dokumentacionit që del nga programi i punës administrative dhe shoqatës, si dhe broshurave dhe teksteve që marrin personat e verbër për shfrytëzim.

Nga Drejtoria e Arsimit kërkohet sigurimi i pajisjeve tifro-teknike dhe tifro-dialektike, në mënyrë që përmes shoqatës komuniteti i verbër të marrë të gjitha shërbimet e nevojshme.

Nga Drejtoria e Pronës, kërkon që prona e cila iu ka dhënë Shoqatës së të Verbërve në vitin 2007, të qitet në pronësi të saj.

Qytetarët e lagjes "Kodra e Trimave", sidomos afër rrugëve "Aziz Zhilivoda" dhe "Frederik Niqe", ankohen se nuk kanë ndriçim dhe duan të dinë se kur mund të përfundojë ndriçimi për këtë pjesë.

Lidhur me pyetje e parashtruar nga z. Deri rreth kërkesës së Shoqatës së të Verbërve për pajisjen me një printer, z. **Muhedin Nushi**, drejtor i Drejtorisë së Administratës, dha sqarime të nevojshme.

Egzon Azemi, pyetje për Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave.

Në cilën fazë gjendet projekti për rregullimin e varrezave të dëshmorëve në Marec? Kur do të fillojë realizimi i Planit të mobilitetit nëpër qytet, dhe kur do të ndajë Komuna fonde për blerjen e biçikletave publike, ashtu siç ka vepruar Tirana apo edhe qytetet tjera?

Lidhur me pyetjen e parashtruar rreth rregullimit të varrezave në fshatin Marec, **Gëzim Mehmeti**, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dha sqarime të nevojshme.

Haki Dragusha, pyetje për Drejtorinë e Shëndetësisë.

Punëtorët e ndërresës së natës të QMF-së, kërkojnë të kryhet pagesa për ndërrimin e natës, por edhe ata të Qendrës për Punë Sociale. Ata ankohen që nuk po iu paguhen as shtesat që i kanë, as për punën gjatë festave, dhe po ashtu ankohen për një punëtor që ka dalë në pension dhe atij prapë i është vazhduar kontrata.

Arben Vitia, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, dha sqarime të nevojshme lidhur me kërkesat e parashtruara nga z. Dragusha.

Leonora Shabani-Bajraktari, pyetje për kryesuesin e Kuvendit.

Kur do të fillojë punën Komiteti për Arsim?

Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, për pyetjen e parashtruar nga znj. Bajraktari dha sqarime të nevojshme.

Valbona Ajeti, kërkesë për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë.

Banorët e lagjes "Sheshi i Arbit", që është në anën e djathtë të rrugës "Bajram Bahtiri", për marrjen e shërbimeve shëndetësore janë të caktuar në QKMF në Kodrën e Trimave, por kërkesë e tyre është që këto shërbime t'i kryejnë në QMF IV, sepse e kanë më afër.

Arben Vitia, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, dha sqarime të nevojshme për pyetjen e parashtruar nga znj. Ajeti.

Mbledhja përfundoi në orën 14:45

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Agim Kuleta